



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo – Republic of Kosovo**  
*Kuvendi – Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura VI**  
**Sesioni vjeshtor**

**Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal**  
Mbledhja nr.49/2018  
Prishtinë, më 22.11.2018, në orën 09:45  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Sala Berisha Shala, kryetare, Liburn Aliu, Lutfi Zharku, Muharrem Nitaj, Veton Berisha dhe Duda Balje, anëtarë.

**Munguan:** Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Glauk Konjufca, Hykmete Bajrami dhe Memli Krasniqi, anëtarë.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Vatra Qehaja, LVV; Dren Ajeti, Klubi i Prodhuesve, si dhe mediet.

**Stafi mbështetës i komisionit:** Armend Ademaj dhe Muhamet Morina.

**Mbledhjen e kryesoi:** Sala Berisha Shala, kryetare e komisionit.

**Rendi i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Plotësimi i Panelit për zgjedhjen e Bordit të NP KOSTT;**
- 3. Të ndryshme.**

*Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.*

## 1. Miratimi i rendit të ditës

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

## 3. Plotësimi i Panelit për zgjedhjen e Bordit të NP KOSTT

**Kryetarja** potencoi se komisioni më herët e ka marrë një vendim për panelin prej tre anëtarësh dhe ai vendim ka qenë në unanimitet të plotë. Ky panel me mbështetjen e partnerit implementues britanik BOD, ka bërë listën e ngushtë të kandidatëve, ku nga 33 që kanë aplikuar janë zgjedhur 29 kandidatë që i plotësojnë kushtet sipas ligjit. Ndërkohë që, edhe në komision ka pasur debat që të zgjerohet paneli. Kam kërkuar nga interpretim ligjor nga administrata e Kuvendit, dhe jam këshilluar që është në rregull që paneli prej tre deputetëve ka bërë listën e ngushtë, ndërsa për intervista të jetë tërë komisioni. Pastaj, sugjerimi i partnerit britanik është që paneli të mos jetë më shumë se shtatë persona. I njoftoj deputetët me procedurat e intervistimit ku theksoj se një kandidat do të marrë kohë për intervistë një orë e gjysmë, ku do jetë intervista me gojë dhe një test psikometrik, po ashtu secili anëtar i panelit duhet të jetë i pranishëm gjatë tërë intervistimit të secilit kandidat. Në mbledhjen kur është caktuar paneli i parë, deputeti Dardan Sejdiu ka thënë se nuk është i interesuar të marrë pjesë në panel, si dhe deputetja Hykmete Bajrami ka kërkuar të zëvendësohet me deputetin Lutfi Zharku për shkak të arsyeve shëndetësore. Ne, sot, duhet t'i caktojmë emrat se kush do të jetë në panel.

**Muharrem Nitaj** propozoi që të caktohet paneli nga një deputet nga të gjitha grupet parlamentare që janë në komision, sepse kështu secili grup do të jetë i përfaqësuar në panel.

**Lutfi Zharku** tha se deputetja znj. Hykmete Bajrami, përsëri do të jetë nga LDK-ja, në këtë panel.

**Veton Berisha** shfaqti shqetësimin se deputetët mund të mungojnë për shkak të agjendave të tjera, sepse procesi i intervistimit mund të zgjasë një javë.

*Pas diskutimeve, komisioni unanimisht, nxori këtë:*

### V E N D I M

1. *Plotësohet Paneli për zgjedhjen e Bordit të KOSTT-it, i formuar më 3.10.2018;*
2. *Në Panel janë të përfaqësuar të gjitha Grupet parlamentare, si vijon: Sala Berisha - Shala (PDK) dhe kryesuese, Adem Hodja (LS), Hykmete Bajrami (LDK), Liburn Aliu (LVV), Muharrem Nitaj (AAK), Veton Berisha (NISMA) dhe Duda Balje (6+), ndërsa vullnetarisht nuk është pjesë e këtij Paneli përfaqësuesi i grupit parlamentar PSD;*
3. *Paneli në bashkëpunim me Projektin e Ambasadës Britanike "BDO" do zhvillojë procesin e intervistimit të kandidatëve, ku gjatë këtij procesi asnjë anëtar i Panelit nuk mund të tërhiqet ose të zëvendësohet më një deputet tjetër;*
4. *Ngarkohet stafi mbështetës i komisionit që t'i afrojnë Panelit të gjitha kushtet e punës të parapara më Ligj, Rregullore të Kuvendit dhe Memorandumin e Bashkëpunimit në mes të kryetarit të Kuvendit dhe Projektit të Ambasadës Britanike "BDO".*

### **3. Të ndryshme**

#### **Çështjet vijuese.**

**Kryetarja** kërkoi nga kryesuesi i grupit të punës për monitorimin e zbatimit të Ligjit për energji elektrike, z. Dardan Sejdiu, ta përfundon punë në nisur vitin e kaluar.

*Komisioni përkrahu propozimin e kryetares.*

**Kryetarja** propozoi që më 26.11.2018 të ftohen në takim institucionet që janë të përfshira në procesin e anëtarësimit të KOSTT-it në ENTSO-E, siç janë ministria e zhvillimit ekonomik, KOSTT-i, ZRRE-ja dhe përfaqësuesi i kryeministrit.

*Komisioni përkrahu propozimin e kryetares.*

**Mbledhja përfundoi në orën 10:15.**

**E përgatiti: Stafi mbështetës i komisionit.**

**Kryetarja e komisionit,**

-----

**Sala BERISHA SHALA**